



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 6304 Prot.

Fier, më 18.05.2026

Projekt - Vendim

Nr. 50 dt. 18.05.2026

“Për dhënien e miratimit ekzekutiv të Bashkisë Fier për fillimin e procedurave të prishjes së objektit shkolla e vjetër 9 - vjeçare “Lili Stravre” Topojë dhe nxjerrjen nga inventari në përdorim të aktiveve (llogaria ekonomike 212) për pasurinë numër 24 dhe numër rendor 3 sipas fletës së inventarit, zk. 3612 (ndërtesë) me sipërfaqje 729 m² në pronësi të Bashkisë Fier (të Qendrës Ekonomike Arsimore)”

Këshillit të Bashkisë Fier sot më datë ____ .05.2026, i paraqitet për shqyrtim projekt vendimi, bazuar në nenit 23 pika 11, nenit 54 shkronja “e/1 dhe k” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 12 pika “f” e ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 mbi “Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 363 datë 01.04.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Topojë, të Qarkut të Fierit”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 510 datë 10.06.2015 “Për miratim procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, shkresa nr. 85 prot. dt. 13.02.2025 e Njësisë Administrative Topojë, e protokolluar me nr. 2009 prot. dt. 13.02.2025 dhe nr. 1078 prot. dt. 10.12.2025 e protokolluar me nr. 14046 dt. 10.12.2025 me lëndë “Kërkesë për prishje objekti Shkolla e vjetër fshati Topojë”,
Kryetari i Bashkisë;

Propozon:

1. Dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të prishjes së objektit shkolla e vjetër 9 - vjeçare “Lili Stravre” Topojë dhe nxjerrjen nga inventari në përdorim të aktiveve (llogaria ekonomike 212) për pasurinë numër 24 dhe numër rendor 3 sipas fletës së inventarit, zk. 3612 (ndërtesë) me sipërfaqje 729 m² në pronësi të Bashkisë Fier (të Qendrës Ekonomike Arsimore)
2. Ngarkohet ekzekutivi për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrativo – ligjore për fillimin e procedurave për prishjen e objektit dhe nxjerrjen nga inventari të kësaj pasurie, sipas përcaktimeve ligjore.

Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave
Konc. M. Petushi

Qendra Ekonomike Arsimore

Drejtores: S. Laze

Drejtores e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit


Drejtores: P. Çina

Drejtores Juridike

Drejtores: E. Kapllanaj

Sekretari i Përgjithshëm

Nikollaq Neço



KRYETARI
Armando SUBASHI

